



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-191
Br. _____

Data 11.11.2019
Datum _____

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.19.11.2019, (e martë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari”, objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq
4. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020
5. Shqyrtimi i draft Statutit të Komunës së Obiliqit
6. Raporti i komisionit komunal sipas vendimit :Nr.I-170
 - a) Raporti me nr. X-1054 te datës 04.11.2019
 - b) Raporti me nr X-1087 të datës 11.11.2019
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.28.10.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Prezent: Burim Gërguri, Florije Jashari, Qendresa Dubova, Linda Sadiku, Hysni Mjeku dhe Slavisa Spasic
Të pranishem tjerë: Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Rifadije Paloja, udhëheqëse e sektorit për kulturë, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesuesi cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për administrimin e Shtëpive të kulturës në Komunën e Obiliqit
4. Shqyrtimi i raportit financiar 9 mujor (DEFZH)
5. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Strategjisë për zhvillimin e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore/natyrore 2019-2023
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelat Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin
7. Shqyrtimi i vendimeve të Kuvendit komunal sipas kërkesave të MAPL-së
 - a) Kërkesa nr.-VI-020-948/9 të dt.03.10.2019
 - b) Kërkesa nr.-VI-0201023/7, të dt.11.10.2019
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u aprovua njëzërit nga të pranishmit,

1. Pika parë e rendit të ditës

Mungoi: Fatmir Bektashi me leje

2. Pika dytë e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Pika tretë e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim më detal rreth Draft Rregullores për administrimin e Shtëpive të kulturës, fjalën ia dha znj.Rifadije Paloja, udhëheqëse e sektorit për kulturë.

Rifadije Paloja – Ne si Drejtori jemi munduar të punojmë dhe konsiderojmë se është shumë e rëndësishme Rregullorja për administrimin e Shtëpive të kulturës. Prandaj ky dokument ju është dërguar juve, që ti paraqitni vërejtjet ose sugjerimet tuaja. Poashtu, aprovimi i këtij dokumenti lehtëson punën e administrimit sidomos të Shtëpisë së kulturës “Xhavit Haziri”

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimitisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Draft Rregullorja për administrimin e Shtëpive të kulturës në Komunën e Obiliqit.

4. Pika katërt e rendit të ditës

Kryesuesi - Për një sqarim më detal rreth raportit financiar 9 muhor, fjalën ia dha drejtoreshës për ekonomi dhe financa.

Zarife Behluli – Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048 dhe Ligjin mbi Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-040, ne e kemi bërë raportin 9 muhor për vitin 2019 për 5 kategoritë ekonomike: paga dhe meditare, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale.

Pastaj, drejtoresha dha një sqarim të gjerë për të gjitha Drejtoritë komunale lidhur me kategoritë ekonomike të cekura më lartë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi i Raportit financiar 9 muhor (DEFZH).

5. Pika e pestë e rendit të ditës

Kryesuesi – Pyeti lidhur me titullin e dokumentit të Draft Strategjisë se a është mundësi reale sepse kur është Strategji nuk guxojmë ti themi mundësi.

Rifadije Paloja – Sqaron se arsyeja që është përdorë ky term është se konsideroj në radhë të parë se duhet ti ruajmë dhe kultivojmë vlerat që i kemi të gjitha llojeve të trashëgimisë. Pastaj në saje të kësaj ekziston, apo nuk ekziston mundësia për zhvillimin turistik.

Kryesuesi - Kërkon nga të pranishmit që të rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit komunal dhënia në diskutim publik e Draft Strategjisë për zhvillimin e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore/natyrore 2019/2023.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal dhënia në diskutim publik e Draft Strategjisë për zhvillimin e turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore/natyrore 2019-2023.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozim Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelat Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin.

Hysni Mjeku – Nuk është e specifikuar dhe ne nuk e dijmë se në cilën pjesë është.

Kryesuesi – Sqaron se fjala është për rrugën “Hoxhë Ali Querkezi” është pjesa e Plemetit, Millosheva, prej xhamisë, pjesa lartë. Unë i ngriti 2 shqetësime se mos jemi vonë dhe e pyes drejtoreshën se a do të kemi mjete.

Zarife Behluli - Përgjegjet po.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelat Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin, - me sqarime shtesë nga Drejtoria e infrastrukturës lokale.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet 2 kërkesa nga MAPL-ja, kërkesën nr.-VI-020-948/9, e dt.03.10.2019 dhe kërkesën nr.-VI-0201023/7, e dt.11.10.2019 lidhur me rishqyrtimin e vendimeve të Kuvendit komunal. Këtu, fjala është për vendimin e Planit parësor shëndetësor për Komunën e Obiliqit 2020-2024 dhe sipas Ministrisë së shëndetësisë vendimi është në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi. Mund të them se këtë dokument e ka sponsorizue Drejtoria e shëndetësisë dhe përgjegjësia bjen mbi këtë Drejtori. Poashtu, ne duhet ta shfuqizojmë edhe vendimin për banorët e fshatit Llazarevë, për ndarjen e 500 m² pronë shoqërore për ndërtimin e një objekti për komunitet.

Hysni Mjeku – Paraqet vërejtje dhe kërkon që në të ardhmen Ekzekutivi i Komunës, të mos na sjellë më në këtë situatë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesave të MAPL-së:

a) Kërkesa nr. –VI-020-948/9, e dt.03.10.2019

b) Kërkesa nr.-VI-0201023/7, e dt.11.10.2019

Kryesuesi – Ju si material e keni marrë edhe Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve, nga raporti i auditimit për Komunën tonë. Në takimin e fundit që kishim me Zyen kombëtare të auditimit, me Ministrinë e mjedisit, MAPL-në dhe OSBE-në, në punëtorinë ditore jemi nda të kënaqur me hapat që i ka ndërmarrë Komuna. Mendoj se tash e tutje edhe KPF-ja, do t'ë merrë obligim që çdo 3 muaj të bëjë pyetje konkrete për rekomandimet që i kemi pasë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit (ZKA) për Komunën e Obiliqit.

8. Pika e tetë e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesat të cilat iu drejtuan Drejtorive përkatëse për shqyrtim:

a) Kërkesa nr.II-31790/2019, e dt.23.09.2019 i rekomandohet DPUKP-së për shqyrtim.

b) Kërkesa nr.I-34899 /2019, e dt. 18.10.2019 i rekomandohet DMM-së, për shqyrtim dhe aprovim.

c) Kërkesa nr.I-35033/2019, e dt. 21.10.2019, i rekomandohet DKUPK-së, për shqyrtim dhe sqarim ligjor, (KPF-ja nuk e rekomandon për Kuvendin komunal për aprovim).

d) Kërkesa nr.I-35633/2019, e dt.25.10.2019 i rekomandohet DPUKP-së, për shqyrtim dhe sqarim ligjor.

e) Kërkesa nr.I-35630/2019, e dt.25.10.2019 dhe

f) Kërkesa nr.I-35631/2019, e dt.25.10.2019, këto kërkesa i drejtohen DPUKP-së, për shqyrtim dhe sqarim ligjor.

KPF-ja, kërkon sqarim nga DPUKP-ja, për Haden e Re se a janë të emëruara rrugët dhe rrugicat.

9. Pika e nëntë e rendit të ditës

Hysni Mjeku – Këtyre ditëve, është bërë pastrimi i lumit Drenica, por pemët e prera janë të shpërndara në pronat private, prandaj kërkoj që këto mbeturina të pastrohen sepse kemi shumë vërejtje nga qytetarët.

Kryesuesi – Kjo çështje do të trajtohet në Këshillin e drejtorëve.

Slavisa Spasic – Pyeti pse sot është i pranishëm vetëm një drejtor.

Zarife Behluli - Përgjegjet se drejtorët tjerë janë në terren.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30.

Procesmbajtese


Azize Zeneli



Kryesuesi i KPF-së


Burim Gërguri